



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
SJ-030
Prishtinë, më 27 prill dhe 3 maj 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 PRILL DHE 3 MAJ 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala.

Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, i hapi punimet e Seancës së jashtëzakonshme, sipas kërkesës së 70 deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar për personat e pagjetur

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e 70 deputetëve të Kuvendit për debat parlamentar për personat e pagjetur.

Në vazhdim kryetari tha se Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka përkrahur organizatat dhe institucionet, të cilat angazhohen për çështjen e personave të pagjetur, si dhe do të mbledhet çdo vit, derisa të përfundojë kjo çështje.

Ai theksoi se duke pasur parasysh se po bëhen dy dekada të dhimbjes dhe pritjes për shumë qytetarë të Kosovës, të cilët janë të pagjetur, Serbia po vazhdon të heshtë dhe po tenton të

nxisë harresën tonë, por Kosova nuk duhet të harrojë, e as nuk do të ndalemi kurrë së kërkuari drejtësi për qytetarët tanë.

Më tej, kryetari tha se Serbia duhet ta ketë të qartë se fshehja e krimeve dhe aspirata për integrim evropian nuk shkojnë bashkë dhe se vetëm drejtësia i shëron plagët e së kaluarës, e jo harrimi i tyre. Ndërsa, institucionet e Kosovës do të bëjnë çdo gjë që është në mundësinë e tyre që të ndriçohet fati i personave të pagjetur, si një obligim kushtetues dhe kombëtar që së bashku t'u qëndrojmë pranë atyre, të cilët ende deri më sot nuk i kanë gjetur të dashurit e tyre.

Më pas kryetari i ftoi përfaqësuesit e propozuesve për debat parlamentar që të marrin fjalën.

Deputetja Saranda Bogujevci tha se që 19 vjet familjet ende jetojnë me dhimbjen që nuk kanë asnjë informatë se ku gjenden familjarët e tyre të pagjetur, si dhe tha se edhe vetë e ka përjetuar këtë dhimbje.

Ajo theksoi se për personat e pagjetur përgjegjësia është shumë e madhe e të gjithëve, përfshirë personat përgjegjës në qeveritë e kaluara karshi bisedimeve me Serbinë, ku çështja e të pagjeturve dhe e krimeve që i ka bërë Serbia është dashur të diskutohet në ato bisedime, për shkak se Serbia nuk është duke i pranuar krimet që i kanë bërë në Kosovë.

Më tej ajo tregoi se para pak ditëve Serbia e ka liruar nga burgu personin e dënuar për vrasjen e familjarëve të saj, pa e përfunduar dënimin, dhe se kjo dëshmon që Serbia nuk do të pranojë fajin, nuk do të pranojë që ka kryer krime në Kosovë, nuk do ta pranojë që i ka informacionet se ku mund t'i gjejmë trupat e personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, e kjo duhet të jetë edhe një mësim tjetër se çka duhet të ndërmarrim ne dhe çka duhet të punojmë që ta shtyjmë Serbinë ta marrë këtë përgjegjësi.

Në fund ajo kërkoi nga komuniteti ndërkombëtar që t'i bëjnë presion Serbisë që çështja e personave të pagjetur të merret si prioritet dhe të ndërmerren hapa konkretë rreth kësaj çështjeje.

Ndërsa deputeti Andin Hoti tha se çështja e personave të pagjetur duhet të zgjidhet, për t'i dhënë fund këtij ankthit 19-vjeçar.

Ai tha se qytetarët, sidomos familjarët e personave të pagjetur, e kuptojnë ndjenjën se si është të rritesh pa babanë, ndjenjën e pritjes nëse do të gjendet, por ai do të jetë zëri i të gjithë atyre që presin dhe kërkojnë të dinë për 1652 personat e pagjetur, për ata që dikush edhe i ka harruar, për ata që nuk e ndjejnë vendosmërinë e institucioneve tona, të paktën duke ushtruar presionin te autoritetet ndërkombëtare dhe të Beogradit para dhe gjatë dialogut.

Ai theksoi se nuk mund të arrihet një paqe për brezat e ardhshëm, ku Serbia nuk tregon as vullnetin minimal për çështje humanitare, siç është çështja e personave të pagjetur. Ndërsa, nëse në dialogun me Serbinë nuk adresohet fati i personave të pagjetur dhe kjo çështje nuk merr përgjigje, atëherë mund të mashtrohemi me idenë e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë.

Më tej, ai tha se Kosova ka fakte dhe dëshmi për krimet dhe gjenocidin që ka bërë policia dhe ushtria serbe, ndërsa Serbia i ka regjistrat dhe statistika për çdo banor të Kosovës, të cilat duhet kërkuar nga Serbia, duhet të kërkohen nga drejtori i atëhershëm i Burgut të Dubravës dhe nga gardianët se ku e kanë çuar babanë, Ukshin Hotin, të dielën, më 16 maj 1999, kur e kanë improvizuar gjoja lirinë e tij. Ndërsa Kosova të jetë e unifikuar që me angazhim serioz dhe me përkushtim më të madh ta zgjidhë çështjen e personave të pagjetur.

Në fund ai tha se me ndihmën e institucioneve vendore e ndërkombëtare nuk do të ndalet së kërkuari drejtësi për personat e pagjetur, deri sa kjo çështje të marrë epilog.

Diskutimet e plota të deputetëve Saranda Bogujevci dhe Andin Hoti janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi i hapi diskutimet për çështjen, për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Për personat e pagjetur diskutuan deputetët: Duda Balje, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Lirije Kajtazi, në emër të GP të LDK-së; Flora Brovina, në emër të GP të PDK-së dhe Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së, si dhe ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Ndërkohë, në sallën e seancës u transmetua një film dokumentar për veprimtarin e çështjes kombëtare Ukshin Hoti dhe për personat e tjerë të pagjetur.

Pastaj, për personat e pagjetur diskutuan edhe këta deputetë: Driton Çausi, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Jasmina Zhivkoviq, në emër të GP të Listës serbe; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”; Milaim Zeka, Blerta Deliu-Kodra, Korab Sejdiu, Adem Mikullovc, Mexhide Mjaku-Topalli, Frashër Krasniqi, Muharrem Nitaj, Naser Rugova, Sala Berisha-Shala, Ismajl Kurteshi, Liburn Aliu, Rasim Selmanaj, Veton Berisha, Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Armend Zemaj, Sami Kurteshi, Fidan Rekaliu, Xhevahire Izmaku, Drita Millaku, Daut Haradinaj, Nait Hasani, Arbërie Nagavci, Fadil Beka, Shemsi Syla, Bekim Haxhiu dhe Fatmire Kollçaku, si dhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e ftoi deputeten Saranda Bogujevci që ta paraqesë tekstin e propozim-rezolutës, të harmonizuar me grupet parlamentare.

Deputetja Saranda Bogujevci e paraqiti tekstin e propozim-rezolutës, të harmonizuar me grupet e tjera parlamentare.

Për shkak të mungesës së kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, propozim-rezoluta nuk u hodh në votim.

Kryetari i ndërpreu punimet e seancës në orën 17:50 minuta, për të vazhduar të enjten, më 3 maj 2018.

* * *

E enjte, më 3 maj 2018

Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 27 prill 2018

Kryesuesi i seancës, z. Xhavit Haliti, i njoftoi deputetët se diskutimet për personat e pagjetur kanë përfunduar më 27 prill 2018, por në mungesë të kuorumit, votimi i propozim-rezolutës ishte shtyrë.

Më pas, kryesuesi e ftoi deputeten Saranda Bogujevci që ta paraqesë tekstin e propozim-rezolutës, të harmonizuar edhe me grupet e tjera parlamentare.

Deputetja Saranda Bogujevci e paraqiti propozim-rezolutën.

Kryesuesi e hodhi në votim propozim-rezolutën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----71,
Kundër----- 4,
Abstenime ----- 0

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Të bëhet zbardhja e fatit të personave të zhdukur me forcë, bazuar në të drejtën ndërkombëtare, përfshirë konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në protokollin shtesë nr. 1, 1977.
2. Zbardhja e fatit të personave të zhdukur me forcë të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi dhe të bëhet pjesë e platformës shtetërore për dialogun. Institucionet e autorizuar për dialog duhet t'i raportojnë Kuvendit dhe komisioneve përkatëse pas çdo takimi me palën serbe për këtë çështje.
3. Subjektet vartëse të politikës parlamentare dhe politikës së jashtme të Kosovës në agjendat e takimeve me përfaqësues të OKB-së, BE-së, shteteve me ndikim në marrëdhënie ndërkombëtare, ta fokusojnë me prioritet zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë dhe për zbatimin e pikave të rezolutës ta njoftojnë Kuvendin e Kosovës.
4. Të gjithë bartësit e detyrave në bazë të pikave të kësaj rezolute t'i qasen në mënyrë të veçantë në dialogun Kosovë - Serbi zbardhjes së fatit të Ukshin Hotit, për shkak të rrethanave të zhdukjes së tij, të planifikuar nga strukturat komanduese ushtarake të shtetit serb, përfshirë drejtorin e Burgut të Dubravës në Istog dhe Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës ta finalizojë deri në fillim të muajit qershor 2018 koncept-dokumentin për çështjen e personave të zhdukur dhe të procedojë me plotësim-ndryshimin e Ligjit për persona të zhdukur, përkatësisht bazës ligjore dhe të njëjtën ta procedojë në Kuvend.
6. Qeveria ta trajtojë me prioritet funksionalizimin e plotë të regjistrit qendror për persona të zhdukur, përfshirë edhe versionin elektronik, me mundësinë e digjitalizimit dhe krijimit të qasjes për publikun, me qëllim të rritjes së transparencës.
7. Qeveria të angazhohet që të lidhë marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të ashtuquajturën “ndihmë juridike”, ngjashëm me marrëveshjen që ka bërë Serbia me Bosnjë e Hercegovinën dhe Kroacinë.
8. Institucionet kompetente të Republikës së Kosovës të angazhohen dhe ta paditin Serbinë si përgjegjëse kryesore për personat e zhdukur, duke përfaqësuar familjarët individualisht, ose si grup, në instancat ndërkombëtare.
9. Qeveria obligohet ta realizojë projektin për shfaqjen e të dhënave rreth personave të zhdukur te përmendorja jashtë objektit të Kuvendit dhe të përfundojë puna e memorialit në Meje të Gjakovës deri në fund të vitit 2018.

10. Të ngrihen kapacitete institucionale të vendit për t'u marrë plotësisht me çështjen e personave të zhdukur me forcë.

11. Të hartohet dhe të procedohet projektligji, i cili mundëson gjykimin e të akuzuarve për krime të luftës në mungesë.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme më 3 maj 2018, në orën 12:10.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*